Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aset në kompetencat administrative të Agjencisë.

Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/18

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr. 01/2025 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore ShAL 71, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet shitja e Njesisë nr.68 - NSh DLB - Parcela 281-0 ZK Dushanovë Prizren me ofertues me çmim 30,800 €.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetin t'a tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e ShAL 71.

Bazuar në Rregullat Tenderit dhe duke qenë se para rreth 8 muaj më herët në SHAL 68 ka pas ofertë pothuajse 3 herë më të lartë në raport me ofertën e pranuar prej 30.800€ është refuzuar shitja e këtij aseti.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aset në kompetencat administrative të Agjencisë.

Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/19

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr. 1/2025 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore ShAL 71, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet shitja e Njesisë nr.69 - NSh DLB - Parcela 285-0 ZK Dushanovë Prizren me ofertues me çmim 15,400 €.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetin t'a tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e ShAL 71.

Bazuar në Rregullat Tenderit dhe në faktin se rreth 7 muaj më herët në SHAL 69 ka pas ofertë shumë më të lartë në raport me ofertën e pranuar prej 15,400 € është refuzuar shitja e këtij aseti.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.

Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/20

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenin 18.1.3, dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në, nenet 10.1.4 dhe 10. 1.5 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të ngastrës kadastrale 07230-1 të NSh Përparimi, i përbërë nga objekti me sipërfaqe prej 71.12 m² dhe hapësirës tokësore në sipërfaqe prej 384.63 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 3,189.00 € për një muaj kalendarik për parashtruesin e kërkesës Olti Trasing.
- II. Kontrata lidhet me 01 maj 2025 është me afat prej tre (3) muajsh me mundësi vazhdimi edhe 3 muaj të tjerë
- III. Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive, duke e llogaritur nga prill 2024 deri në prill 2025, koha nga kur kanë filluar dhe janë identifikuar investimet, konrektisht në objektin që ndodhet brenda parcelës 07230-1 ZK Prishtinë. Për shfrytëzimin e kësaj hapësire qiramarrësit Olti Trasing do të i kërkohej të paguajë retroaktivisht shumën prej 41,457.00 €.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. Lidhur me paragrafin II të këtij vendimi Agjencia ka parasysh faktin se prona në fjalë do të nënshtrohet procedurës së shpronësimit atëherë Bordi mund ta rishikoj vendimin nëse është e nevojshme.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Në prill 2024 ishte identifikuar nga ZR Prishtinë fakti që në asetën e NSh Përparimi, kishte filluar të bëhej pastrimi dhe rregullimi i pjesës së kulmit në objektin prej 71.12 m², i cili ndodhet në parcelën me nr. 07230-1 ZK Prishtinë në pronësi të NSh Përparimi dhe pas kësaj i ishte dërguar një shkresë personit që kishte filluar të bënte këto intervenime pa pëlqimin e AKP-së më datë 16.04.2024. Me datë 22.04.2024 është pranuar një përgjigje nga ana e Olti Trasing me nr. protokoli 24670/2024, ku pala pretendon që në bazë të kontratës së privatizimit në mes të tyre dhe NSh Trasing kjo parcelë është pjesë integrale e parcelave që ka privatizuar nga NSh Trasing dhe se sipas tyre që nga viti 2006 nga koha e privatizimit të asetit kanë menduar se sipërfaqja e kësaj ngastre është pjesë e privatizimit dhe se për këtë arsye kanë bërë edhe rregullimin e kulmit.

Pas kësaj, më datë 07.05.2024 AL ka dërguar një shkresë ku i është bërë e qartë palës që kjo pronë është e AKP-së dhe se brenda afatit të caktuar janë të obliguar të lirojnë hapësirën.

Më datë 15.05.2024 është pranuar një përgjigje tjetër nga ana e parashtruesit të kërkesës, ku prapë kanë pretendimet e njëjta dhe përmes kësaj kërkojnë që të bëhet një zgjidhje e përbashkët rreth kësaj çështje.

Veprimet pasuese të AKP-së kanë qenë me daljen në terren dhe vendosjen e shenjave që kjo parcelë është e AKP-së dhe se ju ndalohet hyrja personave të paautorizuar. Këto shenja ende janë të vendosur dhe në bazë të konfirmeve nga ZR Prishtinë nuk ka pasur ndërhyrje në këtë objekt apo parcelë që nga vendosja e shenjave në atë hapësirë.





Në bazë të vizitës në terren nga ana e zyrtarit të rastit të datës 15.10.2024 është konfirmuar fakti që kjo parcelë dhe objekti nuk janë shfrytëzuar dhe nuk shfrytëzohen as aktualisht, përveç investimeve që janë bërë, ku është vendosur kulmi i ri pasi që i vjetri ka qenë gjysmë i rrënuar dhe janë vendosur dritare të reja në objekt.

Poashtu, ceket se në këtë parcelë janë të vendosura mbeturina para hyrjes së objektit.

Në bazë të këtij konstatimi, vërehet që nuk qëndron fakti i cekur nga pala parashtruese e kërkesës që aseti shfrytëzohet që nga koha e privatizimit të aseteve të NSh Trasing që ndodhen në fqinjësi.

Më datë 22.10.2024, AKP ka pranuar kërkesën për qiradhënie direkte nga ana e Olti Trasing ku kërkohet sipërfaqja prej 384.63 m2, pjesë e së cilës është edhe objekti në sipërfaqe prej 71.12 m2 pronë e NSh Përparimi.

Poashtu, pala më datë 12.12.2024 ka sjellë edhe pëlqimin e dhënë nga ana e KK Prishtinë, ku ofrohet mbështetje për marrjen me qira të këtij aseti duke qenë se kemi të bëjmë me një hapësirë e cila është në gjendje jo të mirë dhe se mirëmbajtja e saj do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin dhe përmirësimin e jetës së banorëve të asaj zone.

Ngastra 07230-1 ZK Prishtinë, në tërësi përfshin sipërfaqen prej 3013 m2, e cila është e pamundshme të lëshohet me qira si një tërësi, sepse në kufi me këtë ngastër ndodhet ngastra 07230-2 në të cilën ndodhet një objekt privat (shtëpi) në pronësi të një personi privat dhe kështu rrugën për hyrje dalje në shtëpinë e tij e ka përmes parcelës 07230-1.

Poashtu, probleme të tjera se përse kjo parcelë nuk mund të lëshohet me qira si tërësi kanë të bëjnë poashtu edhe me faktin që për një pjesë të kësaj ngastre ka objekte të ndërtuara në bazë të kontratave ekzistuese të shfrytëzimit të lëshuara nga KK Prishtinë para vitit 1999. Këto kontrata mund të përfshijnë të drejta të mbrojtura të shfrytëzuesve mbi hapësirën, duke e bërë të pamundur largimin e tyre pa një proces ligjor e të qartë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me palën do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Qiradhënia e kësaj hapësirave është e arsyeshme pasi që është pothuajse pjesë integrale e objektit afarist që kanë në pronësi dhe poashtu dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij.

Aseti aktualisht është i mbyllur dhe nuk është duke e shfrytëzuar dhe duke qenë se kanë kryer investime me pretekstin që kinse është pjesë e kontratës së privatizimit në vitin 2006 dhe se këto investime janë identifikuar menjëherë që në prillin 2024 dhe se të njëjtit kanë parashtruar kërkesë për marrjen me qira të kësaj hapësire, atëherë konsiderojmë që duhet të paguajnë retroaktivisht që nga koha kur kanë filluar të bëjnë ndërhyrje në këtë pjesë të kësaj parcele. Pala ka sjellë edhe letrën mbështetëse nga ana e KK Prishtinë

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/21

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.10.1 të Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore; dhe Neneve 590 dhe 597 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Plotësohet vendimi i Bordit Nr. Ref. BD-219/23 i datës 27.02.2025 dhe caktohet çmimi prej 1,550.00€/muaj për palën Univers shpk – përfaqësuar nga Ridvan Beqiri për qiradhënien e asetit pompë e derivateve të NSh Jugopetroll.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e çështjes sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet e paraqitura në mbledhjen e Bordit të AKP-së të datës 28.02.2025 dhe sipas kërkesës së Bordit për tu bërë rivlerësimi i çmimit të qirasë.

Sipas vlerësimit të AL-së lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtuesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSh-së dhe do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfutës i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/22

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Tregu" dhe parashtruesve të këtyre kërkesave, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSh Tregu:
 1. Nga Ragip Stublla si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 2, 3, 4, 5 në sipërfaqe prej 439 m², ku nga kjo sipërfaqe 55 m² të transferohet në emër të Kadri Kutleshi, 24 m² në emër të Isuf Kongjeli, ndërsa 360 m² të mbetet në emër të Ragip Stublla – përfaqësues i kompanisë Herta SH.P.K. në shumën prej 1,200.00 Euro/muaj;
 2. Nga Skender Rukovci si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 663, 664, 687 dhe 688 në Tregun me Shumicë, me sipërfaqe të përgjithshme 54.26 m², në emër të MENDI XONI SH.P.K., me numër unik identifikues 811899204, përfaqësuar nga Ibadete Rukovci, në shumën prej 106.00 Euro/muaj;
 3. Nga N.P. Cimi si qiramarrës i tokës afariste nr. 49 dhe 90, në emër të Arena Mall SH.P.K., me numër biznesi 811591488, përfaqësuar nga Afrim Sylja, në shumën prej 80.00 Euro/muaj;
 4. Nga N.T.P "MIS SIKS" si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 72, me sipërfaqe prej 40 m², në emër të EDIOS BUTIQUE SH.P.K., me numër fiskal 812209105, përfaqësuar nga Avdi Jashari, në shumën prej 120.00 Euro/muaj;
 5. Nga NTP SHAIPI TEX si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 144, 145, 131, 132, në emër të subjektit të ri SHAIPI TEX SH.P.K., me numër unik identifikues 811985227, përfaqësuar nga Shaip Velu, në shumën prej 180.00 Euro/muaj;
 6. Nga Nazim Korcaj si qiramarrës i stendës nr. 130 në Tregun e Gjellbër (tek RTK), me sipërfaqe prej 2 m², në emër të Bujar Berisha, me numër personal 1019495589, në shumën prej 30.00 Euro/muaj.
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartcekur dhe ndërrimit të emrit, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në të kundërtën do të ndërmirën të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirim të hapësirave:
 - b) Skender Rukovci si qiramarrës i tokave afariste të identifikuar me nr. 663, 664, 687, 688, në Tregun me Shumicë para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek MENDI XONI SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 3,350.00 €;
 - c) N.P. Cimi si qiramarrës i tokave afariste të identifikuar me nr. 49 dhe 90 në Tregun me Shumicë para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek Arena Mall SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 295.60 €;
 - d) N.T.P "MIS SIKS" si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 72, me sipërfaqe prej 40 m² në Tregun me Shumicë (Tekstil), para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek EDIOS BUTIQUE SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 110.85 €;
 - e) NTP SHAIPI TEX si qiramarrës i tokave afariste të identifikuar me nr. 144, 145, 131, 132 në Tregun me Shumicë (Tekstil), para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek SHAIPI TEX SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 166.27 €;
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.



ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Më datë 29/01/2025, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 26070/2025 e parashtruar nga pala z. Ragip Stublla, shfrytëzues i tokës afariste nr. 2, 3, 4, 5, për transferimin e pjesshëm të kontratës së qirasë nga "Ragip Stublla" në emër të "Kadri Kutleshi" për 55 m² dhe "Isuf Kongjeli" për 24 m².

Qiramarrësi Ragip Stublla ka hyrë në kontratë të qirasë me nr. protokolli 47415/2023 të datës 23/06/2023 për shfrytëzimin e tokës afariste të identifikuar me nr. 2, 3, 4, 5, me sipërfaqe 439 m², të ndodhur në Tregun me Shumicë (Tekstil) në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve), në shumën prej 1,200 €/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 0.00 €.

Në kërkesën e parashtruar, qiramarrësi ka kërkuar që transferimi i qirasë të bëhet nga data X.

Më datë 18/03/2025, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 26249/2025 e parashtruar nga pala z. Skender Rukovci, shfrytëzues i tokës afariste nr. 663, 664, 687, 688, për transferimin e plotë të kontratës së qirasë nga "Skender Rukovci" në emër të biznesit "MENDI XONI SH.P.K.", përfaqësuar nga Ibadete Rukovci.

Qiramarrësi Skender Rukovci ka hyrë në kontratë të qirasë me nr. protokolli 54601/2024 të datës 28/12/2024 për shfrytëzimin e tokës afariste të identifikuar me nr. 663, 664, 687, 688, me sipërfaqe 27.74 m², 13.26 m², 13.26 m², të ndodhura në Tregun me Shumicë (Tekstil) në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve), në shumën prej 106.00 €/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 3,350 €.

Më datë 18/03/2025, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 26215/2025 e parashtruar nga pala N.P. Cimi, shfrytëzues i tokës afariste nr. 49, 90, për transferimin e plotë të kontratës së qirasë nga "N.P. Cimi" në emër të biznesit "Arena Mall SH.P.K.", me numër biznesi 811591488, përfaqësuar nga Afrim Sylja.

Qiramarrësi Afrim Sylja ka hyrë në kontratë të qirasë me nr. protokolli 47343/2023 të datës 21/06/2023 për shfrytëzimin e tokës afariste të identifikuar me nr. 49 dhe 90, me sipërfaqe 28 m², të ndodhura në Tregun me Shumicë (Tekstil) në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve), në shumën prej 80.00 €/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 295.60 €.

Më datë 18/03/2025, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 26292/2025 e parashtruar nga pala Avdi Jashari, shfrytëzues i tokës afariste nr. 72, për transferimin e plotë të kontratës së qirasë nga "N.T.P MIS SIKS", me numër fiskal 810491126, në emër të subjektit të ri afarist "EDIOS BUTIQUE SH.P.K.", me numër fiskal 812209105, duke ruajtur përfaqësuesin ekzistues Avdi Jashari.

Qiramarrësi Avdi Jashari ka hyrë në kontratë të qirasë me nr. protokolli 47453/2023 të datës 23/06/2023 për shfrytëzimin e tokës afariste të identifikuar me nr. 72, me sipërfaqe 40 m², të ndodhur në Tregun me Shumicë (Tekstil) në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve), në shumën prej 120.00 €/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 110.85 €.

Më datë 18/03/2025, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 26290/2025 e parashtruar nga z. Shaip Veliu, për ndryshimin e emërimit në faturat mujore të qirasë për tokën afariste me numër identifikues 144, 145, 131, 132, nga "N.T.P SHAIPI TEX", me numër unik identifikues 810211110 dhe numër fiskal 601643184 (biznes individual i Qëndresa Velikut, statusi i të cilit është "Shuar" më 11/11/2022), në emër të subjektit të ri afarist "SHAIPI TEX SH.P.K.", me numër unik identifikues 811985227, të regjistruar më 11/11/2022, duke ruajtur përfaqësuesen ekzistuese Qendresa Veliu.



N.T.P SHAUPI TEX ka hyrë në kontratë të qirasë me nr. protokoli 47571/2023 të datës 23/06/2023, për shfrytëzimin e tokës afariste të identifikuar me nr. 144, 145, 131, 132, me sipërfaqe totale të kontraktuar dhe çmim qiraje prej 180.00 €/muaj. E njëjta ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 166.27 €.

Më datë 18/04/2025, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokoli 26379/2025 e parashtruar nga pala Nazim Korça, shfrytëzues i tokës afariste me numër identifikues 130, për transferimin e plotë të kontratës së qirasë nga "Nazim Korça", me numër personal 2006001427, në emër të z. Bujar Berisha, me numër personal 1019495589.

Qiramarrësi Nazim Korça ka hyrë në kontratë të qirasë me nr. protokoli 43961/2022 të datës 12/12/2022 për shfrytëzimin e tokës afariste/stenda metalike të identifikuar me nr. 130, me sipërfaqe 2 m², e ndodhur në Aneksin e Tregut të Gjellbër (Stenda Metalike), Rr. "Ilaz Agushi", në shumën prej 30.00 €/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 0.00 €.

Kontratat tek personat tek të cilët do të transferohen nuk do të dorëzohen deri sa të paguajnë borxhin e papaguar, dhe po ashtu do të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore në rast se ky borxh nuk paguhet dhe do të kërkohet edhe lirim i pjesëve të tokave afariste specifike.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratave të Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Duke qenë se NSH Tregu është me karakter specifik dhe hapësirat e vendosura në tokën afariste janë të ndërtuara nga vetë qiramarrësit dhe të lejohet transferimi i kontratave të qirasë edhe pse në mes të qiramarrësit dhe personit që pranon transferimin e kontratës së qirasë nuk ka lidhje familjare dhe të kihet parasysh se cedimi apo transferimi i këtyre kontratave të qirasë ju bëhet personave që ushtrojnë veprimtari të tregtisë.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/23

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Neni 10. 1.2 dhe neni 10.3 të Rregullores Nr. Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për marrjen me qira për shfrytëzimin e lokalit nga Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës në vlerën prej 150.00€ për një muaj kalendarik për pronën e NSh "Dunav Osiguranje", me lokacion në Veri të Mitrovicës në udhëkryqin e rrugëve Sutjeska dhe Rr. Mbreti Petar I.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim .

Ndërmarrja Shoqërore NSh "Dunav Osiguranje" (në likuidim) ka filluar likuidimin me datën 26.02.2020. Autoriteti i Likuidimit i kësaj ndërmarrje menaxhon me asetet që janë subjekt i qiradhënies. Këto hapësira të objektit të Ndërmarrjes "Dunav Osiguranje" po kërkohen të shfrytëzohen për zyre nga Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Lokali i NSh "Dunav Osiguranje" i cili ndodhet në Mitrovicën Veriore është me sipërfaqe prej përafërsisht 49m². Sipas kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, është cekur se më herët kjo Agjenci ka pasur me qira lokalin afarist të NSh Trepça Komerc në Mitrovicën Veriore por për shkak të mos-funksionimit të lokalit përkatës si pasojë e dëmeve në nyjën sanitare për të cilën kërkohet investim i madh, dhe për këtë shkak po kërkohet me mirëkuptim që të marrin me qira lokalin e NSh "Dunav Osiguranje", me lokacion në Veri të Mitrovicës në udhëkryqin e rrugëve Sutjeska dhe Rr. Mbreti Petar I, të cilët e shohin si lokacion mjaft të përshtatshëm për zgjerimin e aktivitetit institucional në këtë pjesë të Mitrovicës. Kërkesa e tyre për qira është në vlerën mujore prej 150.00€.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, atëherë konform neni 10 par.3 të Rregullores për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që asetit do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, sipas kërkesës AKVP deklaruar se ka mundësi të paguaj shumë prej 150.00 Euro në muaj (bruto).

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevojat e NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxheti të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/24

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.5 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:


V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të:

- a) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 2/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 68 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 135.00 €/muaj për parashtruesen e kërkesës Donjeta Halimi.
- b) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 2/B – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 71 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 141.00 €/muaj për parashtruesen e kërkesës Pro Star SH.P.K (Resmie Halimi).
- c) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 2/C – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 44 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 87.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Noan Shoes SH.P.K (Fejzullah Halimi).
- d) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot e llojit material i vrazhdë nr. 12/A dhe 17/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 181.50 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 359.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës UKA HOME SH.P.K (Enver Uka).
- e) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura hapësirat afariste/depot nr. 156, 167, 681, 682, 535, 565 dhe 566 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 98 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 194.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës UKA HOME SH.P.K (Enver Uka)
- f) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstrukt metalik nr. 8,9, 38 dhe 39 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 56 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 111.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Arbër Mustafa.
- g) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstrukt metalik nr. 27-B – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 28 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 55.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Muhamed Rudari.
- h) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot e llojit konstrukt metalik nr. 104, 105, 126 dhe 127 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 56 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 111.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Alban Zhegrova.
- i) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot e llojit konstrukt metalik nr. 197,198,218 dhe 219 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 56 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 111.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Ilir Zhegrova.
- j) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 547 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 50 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 99.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Sherif Muja.



- k) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstrukt metalik nr. 9/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 63 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 125.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Leotrim Stublla.
- l) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot e llojit konstrukt metalik nr. 607 dhe 608 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 28 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 55.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Amir Krasniqi.
- m) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot e llojit konstrukt metalik nr. 767,768,765 dhe 766 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 56 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 111.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Arton Mulliqi.
- n) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstrukt metalik nr. 46 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 150 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 297.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Lulzim Shushnjaku.
- o) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 24/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 400 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 792.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Raif Shushnjaku.
- p) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot e llojit konstrukt metalik nr. 707 dhe 708 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 28 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 55.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Faton Bilalli.
- q) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstrukt metalik nr. 131 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 70.60 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 140.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Albert Potera.
- r) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot e llojit material i vrazhdë nr. 16/A dhe 18/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), në sipërfaqe prej 116 m² sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 230.00 €/muaj për secilën hapësirë për parashtruesin e kërkesës MEDI-TONI SH.P.K (Bekim Rama).
- II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesit e kërkesave para nënshkrimit të kontratave të qirasë do të duhet të paguajnë shumat si në vijim:
- a) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 2/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesja e kërkesës Donjeta Halimi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumën prej 135€ – respektivisht (135€/muaj × 1 muaj).
- b) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 2/B – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesja e kërkesës Pro Star SH.P.K (Resmie Halimi) duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumën prej 141€ – respektivisht (141€/muaj × 1 muaj).
- c) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 2/C – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Noan Shoes SH.P.K (Fejzullah Halimi) duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumën prej 87€ – respektivisht (87€/muaj × 1 muaj).
- d) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot nga materiali i vrazhdë nr. 12/A dhe 17/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës UKA HOME SH.P.K (Enver Uka) duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar (Nëntor 2024 – Prill 2025) shumën prej 2,154€ – respektivisht (359€/muaj × 6 muaj).



- e) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura hapësirat afariste/depot nr. 156, 167, 681, 682, 535, 565 dhe 566 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës UKA HOME SH.P.K (Enver Uka) duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar (Nëntor 2024 – Prill 2025) shumë prej 1,164€ – respektivisht ($194\text{€}/\text{muaj} \times 6 \text{ muajt}$)
- f) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstrukt metalik nr. 8,9, 38 dhe 39 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Arbër Musfata duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 111€ – respektivisht ($111\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- g) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstrukt metalik nr. 27-B – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Muhamed Rudari duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 55€ – respektivisht ($55\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- h) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstrukt metalik nr. 104, 105, 126 dhe 127 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Alban Zhegrova duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 111€ – respektivisht ($111\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- i) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstrukt metalik nr. 197,198,218 dhe 219 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Ilir Zhegrova duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 111€ – respektivisht ($111\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- j) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 547 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Sherif Muja duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 99€ – respektivisht ($99\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- k) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstrukt metalik nr. 9/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Leotrim Stublla duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 125€ – respektivisht ($125\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- l) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstrukt metalik nr. 607 dhe 608 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Amir Krasniqi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 55€ – respektivisht ($55\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- m) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstrukt metalik nr. 767,768,765 dhe 766 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Arton Mulliqi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 111€ – respektivisht ($111\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- n) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstrukt metalik nr. 46 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Lulzim Shushnjaku duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumë prej 297€ – respektivisht ($297\text{€}/\text{muaj} \times 1 \text{ muajt}$).
- o) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 24/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Raif Shushnjaku duhet të paguajë



retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumën prej 792€ – respektivisht (792€/muaj × 1 muaj).

- p) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstrukt metalik nr. 707 dhe 708 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Faton Bilalli duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Prill 2025) shumën prej 55€ – respektivisht (55€/muaj × 1 muaj).
- q) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstrukt metalik nr. 131 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Albert Potera duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 8 muajt e kaluar (Tetor 2024 – Prill 2025) shumën prej 1,120€ – respektivisht (140€/muaj × 8 muaj).
- r) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot nga materiali i vrazhdë nr. 16/A dhe 18/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës MEDI-TONI SH.P.K (Bekim Rama) duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 8 muajt e kaluar (Shtator 2024 – Prill 2025) shumën prej 3,680€ – respektivisht (230€/muaj × 8 muaj × 2 hapësira)

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar 18 kërkesa zyrtare nga aplikues të ndryshëm të cekur në dispozitiv të këtij vendimi, të cilët kanë kërkuar qiradhënien direkte të hapësirave afariste (toka) për qëllime magazinimi (depo) në këtë zonë.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 376/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë për asetet të cilat nuk kanë mundur ti sigurojnë herën e parë e vendim të DE 349/2024, prandaj bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren janë matur asetet e mëposhtme dhe çmimi i hapësirave të ofruar me qira tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë, Tregu në Ulpianë dhe Tregu i Gjellbër tek RTK duhet të jetë sipas matjeve të paraqitura në raportin e vlerësimit.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesit e këtyre kërkesave, tanimë edhe shfrytëzuesit e këtyre hapësirave do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Prona e cila do të vlerësohet për dhënie me qira, sipas dokumentacionit të poseduar nga AKP, ZR Prishtinë, dhe sipas listës së aseteve, është tokë afariste përkatësisht treg.



Kësisoj, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga data kur secili ka hyrë në shfrytëzim të këtyre hapësirave. Andaj, nga palët do të kërkohet që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga datat e poshtëshënuara për secilin prej tyre.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/25

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.5 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të ngastrave kadastrale në Lutogllavë 1, të përbëra nga ngastrat 00105-1; 00107-1; 00107-2; 00108-0 dhe 00109-0 ZK Lutogllavë me sipërfaqe të përgjithshme prej 4ha 71ari dhe 27 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 500.00 € për një vit kalendarik për parashtruesin e kërkesës Besim Kuqi.
- II. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të ngastrave kadastrale në Lutogllavë 1, të përbëra nga ngastrat 00117-1; 00117-2; 00118-0; 00120-1; 00121-0; 00123-1; 00123-2; 00124; 00125-1; 00125-2; 00125-3; 00128-0; 00129-0; 00130-1; 00130-2; 00132-0 dhe 00133-1 ZK Lutogllavë në sipërfaqe të përgjithshme prej 13ha 35 ari e 16 m2 sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 1,400.00 € për një vit kalendarik për parashtruesin e kërkesës Mirfat Gashi.
- III. Kontrata pasi që është për tokë bujqësore do të nënshkruhet retroaktivisht nga janari 2025, periudha prej së cilës janë vërejtur punimet.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim

Ndërmarrja Shoqërore NSh Përparimi, PEJ055, është në proces të likuidimit që nga data 09 Qershor 2014. Kjo ndërmarrje ka vazhduar me aktivitetet e saj edhe gjatë procesit të likuidimit kryesisht në ruajtjen dhe qiradhënien e asetëve..

Në janar 2025 në bazë të raportit të vizitës në terren është vërejtur që parcelat e lartë cekura me destinim bujqësor janë punuar dhe pastaj është gjetur se nga kush kanë filluar të punohen dhe më datë 17 mars 2025, ju është dërguar kërkesa nga ana e Autoritetit të Likuidimit palëve Besim Kuqi dhe Mirfat Gashi që të prezantojnë dëshmi pronësore dhe dëshmi të tjera mbi shfrytëzimin e këtyre parcelave.

Më datë 24 mars 2025 Agjencia ka pranuar përgjigje nga ana e Besim Kuqi i cili ka pranuar që ka filluar ta shfrytëzojë grupin e parcelave në Lutogllavë 1 dhe e ka mbjellur me kulturë bujqësore dhe se është i gatshëm të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me AKP-në.

Më datë 21 mars 2025 Agjencia ka pranuar përgjigje edhe nga pala Mirfat Gashi i cili është shfrytëzues i parcelave në Lutogllavë 2 dhe poashtu i njëjti deklaroi që ka menduar që janë pjesë e parcelave të familjes Bardhi dhe ka deklaruar që është i gatshëm që të hyjë në marrëveshje kontraktuale me AKP-në.

Në një pjesë të këtyre parcelave është një ndërtim ilegal (shtallë) nga familja Bardhi për të cilën është parashtruar padi ndaj Besim Bardhi për kthim në gjendjen e mëparshme dhe kompensim dëmi. Familja Bardhi kishte pretendime pronësore ndaj këtyre parcelave dhe ka pasur të iniciuar edhe procedurë gjyqësore në lidhje me pronësinë, e cila është vendosur në favor të AKP-së. Ngastrat në të cilat prek ndërtimi ilegal dhe për të cilat kemi iniciuar padinë nuk janë të përfshira në pjesën e ngastrave të propozuara për qiradhënie.



Në bazë të vizitave periodike në terren dhe në bazë të informatave është viti i parë që këto parcela kanë filluar të shfrytëzohen.

Këto prona kanë qenë të ofertuara për qiradhënie përmes tenderit publik të mbajtur më datë 14.01.2025, mirëpo për këto asete nuk është pranuar asnjë ofertë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me palët do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Qiradhënia e këtyre hapësirave është e arsyeshme pasi që është pothuajse pjesë integrale e objektit afarist që kanë në pronësi dhe poashtu dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij.

Gjithashtu, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga janari 2024, pasi që në këtë kohë janë vërejtur që këto parcela janë punuar. Andaj, do të kërkohet që kontrata të nënshkruhet retroaktivisht nga janari 2025, pasi që edhe kontrata është vjetore për shkak të destinimit të parcelave si bujqësore.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/26

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.5 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të ngastrave kadastrale në pronësi të NSh Ereniku "Prodhimtaria Primare" PEJ029;
 - a) Kërkesa e Rrahman Hoti për qiramarrje të pjesëve të ngastrave kadastrale 54K-0; 0055K-0; 0065K-0; 0071K-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 18ha e 04 ari për shumën prej 1,770.00 Euro për një vit kalendarik;
 - b) Kërkesa e Berat Hoti për qiramarrje të pjesëve të ngastrave kadastrale 0055K-0; 0056K-0; 0064K-0; 0065K-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 8 hektar për shumën prej 770.00 Euro për një vit kalendarik;
 - c) Kërkesa e Burhan Kelmendi për qiramarrje të pjesëve të ngastrave kadastrale 0056K-0; 0057K-0; 0063K-0 dhe 0064K-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 15ha e 02 ari për shumën prej 1,460.00 Euro për një vit kalendarik.
- II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive prej tri vitesh do të paguajnë si në vijim:
 - a) Pala Rrahman Hoti do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 5,310.00 Euro (vitet 2022; 2023 dhe 2024);
 - b) Pala Berat Hoti do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 2,310.00 Euro (vitet 2022; 2023 dhe 2024);
 - c) Pala Burhan Kelmendi do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 4,380.00 Euro (vitet 2022; 2023 dhe 2024).
- III. Kontratat e qirasë pasi që janë kontrata për tokë bujqësore do të nënshkruhen retroaktivisht me efektivitet nga janari 2025 dhe për periudhën nga janari 2025 pala do të jetë i obliguar të paguajë shumën e përcaktuar në pikën I të këtij dispozitivi për një vit kalendarik.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim

Ngastrat kadastrale 0054K-0; 0055K-0; 0065K-0; 0071K-0; 0056K-0; 0064K-0; 0057K-0 dhe 0063K-0 janë në pronësi të NSh "Ereniku Prodhimtaria Primare" PEJ029.

Zyrtarët e AKP-së kanë vërejtur që kjo pronë është duke u shfrytëzuar për të mbjellura bujqësore dhe më pastaj kanë identifikuar edhe shfrytëzuesin. Palëve i është dërguar kërkesë nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të prezantojë dëshmitë mbi bazën e shfrytëzimit të këtyre parcelave më datë 14.03.2025.



Më datë 21 mars 2025 Agjencia ka pranuar përgjigje nga ana e Burhan Kelmendi me nr. Protokolli 76-2025 përmes së cilës ka deklaruar se i shfrytëzon pjesë të caktuara të ngastrave 0056K-0; 0057K-0; 0063K-0 dhe 0064k-0 ZK Gjakovë jashtë qytet dhe se është i gatshëm të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me AKP-në.

Më datë 23 mars 2025 Agjencia ka pranuar përgjigje nga ana e Berat Hoti me nr. Protokolli 80-2025, i cili ka deklaruar se shfrytëzon pjesë nga ngastrat 0055K-0; 0056K-0; 0064K-0 dhe 0065K-0 ZK Gjakovë jashtë qytet dhe se është i gatshëm të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me AKP-në.

Më datë 23 mars 2025 Agjencia ka pranuar poashtu përgjigjen nga ana e Rrahman Hoti me nr. Protokolli 81-2025 përmes së cilës ka deklaruar që shfrytëzon pjesë nga ngastrat 0054K-0; 0055K-0; 0065K-0 dhe 0071K-0 ZK Gjakovë jashtë qytet dhe se është i gatshëm të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me AKP-në.

Në bazë të raportit të vizitën në terren të datë 14.11.2024 është evidentuar fakti që këto parcelë shfrytëzohen nga ana e këtyre palëve.

Për më tepër, një pjesë e këtyre ngastrave kanë qenë të ofruara për qira përmes tenderit publik më datë 14.01.2025 dhe për të cilat ishte shpallur fitues Adnan Krasniqi. Më datë 27.02.2025 Agjencia ka pranuar shkresë nga ana e Adnan Krasniqi përmes së cilës i njëjti ka njoftuar që tërhiqet nga qiramarrja për arsye se kanë kuptuar që këto parcela punohen nga disa palë dhe dëshirojnë të evitojnë ndonjë problem eventual.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me palën do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Qiradhënia e këtyre hapësirave është e arsyeshme pasi që momentalisht janë duke u shfrytëzuar nga këto palë dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij.

Palët vërehet që janë duke i shfrytëzuar ngastrat kadastrale edhe më parë, mirëpo përderisa nuk mund të saktësohet periudha e shfrytëzimit në bazë të të dhënave që pranohen nga Zyra Rajonale, atëherë Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, që nga pala do të kërkohet që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive për tri (3) vite deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/27

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.4 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkt të lokalit afarist Lux në Mitrovicën e Veriut në sipërfaqe prej 260 m2 për Miroslav Savic sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 260.00 Euro/muaj për asetën e NSH LUX.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim:

NSH "Lux" Mitrovicë MIT039 është në proces të likuidimit që nga data 19 gusht 2013. Kjo ndërmarrje ka vazhduar me aktivitetet e saj edhe gjatë procesit të likuidimit por kryesisht në qiradhënie të aseteve të mbetura.

Më datë 18.03.2025 Agjencia ka pranuar kërkesën nga pala Miroslav Savic për qiramarrjen e lokalit afarist 29 NËNTORI me sipërfaqe prej 142.3 m2 e cila gjendet në Rr. Princi Millosh pn, Mitrovicë Veriore. Lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 661/2025 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist me sipërfaqe prej 142.3 m2 e cila gjendet në Mitrovicën Veriore është në shumën prej 260.00 Euro/muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevojat e NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.


Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-223/28

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Autoritetit të Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Zastava Ramiz Sadiku (në likuidim) PEJ089 nga Rajoni i Pejës.
- II. Në listën e kreditorëve për pagesë (Shtojca 3) janë të përfshirë shtatë (7) kreditorë, të cilët do të paguhet në shumën totale prej 7,940.99 €, duke përfshirë edhe shpenzimet gjyqësore për një pjesë prej tyre, dhe Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Trustin Pensional.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes e përkohshme për kreditorët e NSh Zastava Ramiz Sadiku (në likuidim) PEJ089 nga Rajoni i Pejës.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Zastava Ramiz Sadiku (në likuidim) PEJ089 nga Rajoni i Pejës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/29

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PEJ080 NSh Metaliku Emali (në likuidim) nga Rajoni i Pejës në shumën totale prej 3,458.03 Euro për dy kreditor.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes plotësuese të përkohshme për kreditorët e PEJ080 NSh Metaliku Emali (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes plotësuese të Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PEJ080 NSh Metaliku Emali (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/30

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për GJI063 NSH "Lola Korporacija" (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 43,000.00 € dhe atë për vijat buxhetore në vijim:
 - e19 (Tatimi i të ardhurave personale për ofruesit e shërbimeve) në vlerën prej € 38,000.00
 - e22 (Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve) në vlerën prej € 5,000.00
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSH GJI063 NSH "Lola Korporacija".

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për Tatimin e të ardhurave personale për ofruesit e shërbimeve dhe për Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve - pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSH GJI063 NSH "Lola Korporacija". Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/31

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregullores Nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, Nenit 42 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Ligjit Nr. 2003/11 për Rugët dhe Nenit 3.10.4 i Rregullores Nr. 08/2023 për Politika dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset i siç përshkruhet në certifikatën e pronësisë me nr. P-71011021-00010-5 ZK Poterq i Epërm me sipërfaqe totale prej 140 m2 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset i KBI Bujqësia” PEJ055.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, këto asete do të kalojnë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastra kadastrale numër P-71011021-00010-5 ZK Poterq i Epërm në pronësi të NSH “KBI Bujqësia” PEJ055.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastra që është objekt i këtij vendimi sipas gjendjes faktike është evidentuar si rrugë, e cila shërben për lëvizjen e qytetarëve

Në këtë rast duke qenë se kategorizohet si rrugë, duke pasur parasysh edhe nenin 6 par.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rugët, në të cilin parashihet që “rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike”.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aset i nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rugët “asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjesë të rrugës publike”.

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-223/32

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregullores Nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, Nenit 42 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Neni 8 dhe 9 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe Nenit 3.10.4 i Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset nr. P-71011026-00130-2 ZK Dollovë me sipërfaqe prej 4556 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset pronë e NSH "Mirusha" PEJ068.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastrat kadastrale numër nr. P-71011026-00130-2 ZK Dollovë në pronësi të NSH "Mirusha" PEJ068.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastrat kadastrale P-71011026-00130-2 për faktin se kjo parcelë është e evidentuar si Rajon Ujor – Lum, siç përshkruhet në raportin e vizitës në terren.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aset nuk është fitimprurës dhe mund të klasifikohet si pasuri ujore artificiale, përveç kësaj në pajtim me nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës pasuri ujore artificiale përfshin "resurset ujore të cilat janë krijuar si rezultat i zhvendosjes apo rregullimit të rrjedhave natyrore ujore". Për më tepër, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Ujërat të Kosovës "Me qëllim të mbrojtjes së ujërave, shfrytëzimit të përgjithshëm të ujit, pasurive tjera ujore të cilat kryhen për nevoja të interesit publik, pronarit ose poseduesit të tokës dhe të resurseve ujore, mund t'i kufizohet shfrytëzimi i tyre, në pajtim me ligjin".

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-223/33

Në bazë të neneve 5.1.1.2 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 prill 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve, lidhur me përcaktimin e statusit të: Kooperativës Zejtare Banesore "Bashkimi" Prishtinë/Kosovë - KPS 1367/PRN038 sipas së cilit konstatohet se Kooperativa Zejtare Banesore "Bashkimi" Prishtinë/Kosovë – KPS1367/PRN038 si dhe çdo aset i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen, janë në pronësi shoqërore dhe bien nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku sipas tij bazuar në nenin 5.1.1.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L034, si dhe dëshmive të dokumentuara në dosjet e lëndëve të lartcekura në të cilat është dëshmuar se se Kooperativës Zejtare Banesore "Bashkimi" Prishtinë/Kosovë - KPS 1367/PRN038, si dhe çdo aset tjetër i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen janë pronësi shoqërore dhe bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 prill 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit